



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 1, datë 07.01.2021

PËR
NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR.599, DATË 02.12.2020 TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 e 117 të Kodit të Procedurave Administrative në nenet 2 e 89, 99 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, si dhe në informacionin e dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me email të datës 06.01.2021, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Ndryshimin e pikës 9, nëndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”, paragrafi I, të Vendimit nr.599, datë 02.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Oltjona Goxha (relatorë), Artan Gjermani dhe Lazër Sallaku, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}; Akuza: “Neni 283/1 dhe 284/2 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR